



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

**V E N D I M**

**Nr. 46, Datë 17/05/2024**

**“Për mbylljen e procesit të regjistrimit të kandidatëve, për Rektor dhe Anëtar të Senatit Akademik, nga radhët e personelit akademik dhe ato të studentëve, pranë KIZ”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu IV, neni 17; Kreu II, neni 23/3 pika 5, Vendimit Nr. 45, datë 10.05.2024, të KIZ të UT-së, në mbledhjen e datës 17/05/2024, KIZ:

**V E N D O S I:**

1. Mbylljen e procesit të regjistrimit të kandidatëve pranë KIZ, për Rektor dhe Anëtar të Senatit Akademik, nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë dhe ato të studentëve, më datë 17.05.2024, në orën 16:00.
2. Fillimin e menjëhershëm të procesit të shqyrtimit të aplikimeve, të të gjithë kandidatëve të regjistruar dhe shpalljes së listës përfundimtare të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret brenda datës 19.05.2024, ora 16:00.
3. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Rektoratit të UT-së dhe në faqen zyrtare elektronike, si edhe në të gjitha mjediset dhe faqet zyrtare elektronike të të gjitha njësive kryesore të UT-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



## KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

1. Leticja Gusho (Kryetare)
2. Arjan Tushaj (Anëtar)
3. Alnida Koroshi -//-
4. Eljon Doçe -//-
5. Etlon Peppo -//-
6. Shaniko Allajbeu -//-
7. Dhurata Saraçi -//-

